

Kodeksi për sjelljet e nxënësve në kohë pandemie

- 1. Nxënësit janë të obliguar të gjenden në oborrin e shkollës në ora 7:00 ndërrimi i pare dhe ora 12:30 ndërrimi i dyte.*
- 2. Reshtimi i nxënësve të bëhet sipas mundësive me distancë 1.5 m, kujdeset arsimtari kujdestarë dite.*
- 3. Të gjithë nxënësve ju matet temperatura trupore para hyrjes në shkollë me termometër digjital pa kontakt fizik,.*
- 4. Gjatë kohës së orëve mësimore nxënësit janë të detyruar të mbajnë maska dhe në hyrje të dezinfektojnë këmbët dhe duart, distancë 1.5 m si dhe të ketë atmosferë pune.*
- 5. Në qoftë se nxënësit kanë vërejtjet e tyre mbi ndonjë orë duhet ta paraqesin te kujdestari i ditës.*
- 6. Ndalohet përshëndetja me kontakt fizik për nxënësit në shkollë.*
- 7. Përdorimi i tualeteve organizohet në mënyrë që të mundësohet prani më e vogël e nxënësve dhe mbajtja e distancës (p.sh. nëse tualetit është i vogël nxënësi duhet të pres jashtë tualetit derisa të dalë nxënësi i cili gjendet brenda).*
- 8. Nxënësit sjellin racion/ushqim nga shtëpia. Nxënësit racionin e konsumojnë në klasë ku realizojnë mësimi dhe vetëm atëherë ju lejohe të largojnë maskën/ mbulesën nga fytyra në klasë.*
- 9. Nxënësit i lajnë duart para dhe pas ngrënies, para dhe pas përdorimit të tualetit para dhe pas ardhjes nga jashtë dhe kur duart duken të ndyta/përlyera.*
- 10. Në kohën e pushimeve të gjata dhe të shkurta nxënësit nuk duhet të lejojnë prishjen e rendit dhe disiplinës në shkollë,*
- 11. Nëse paraqitet ndonjë problem duhet të kërkohet ndihmë nga arsimtari kujdestar.*
- 12. Pas kryerjes së orës së fundit, nxënësit duhet ta lëshojnë objektin e shkollës pa vrapime, pa zhurmë.*
- 13. Nxënësit gjithmonë duhet të kenë kujdes mos të përdorin fjalë fyese.*
- 14. Detyra e nxënësit është t'i përshëndesin dhe respektojnë më të vjetrit dhe të sillen mirë me nxënësit tjerë dhe të rriturit në shkollë dhe jashta saj .*
- 15. Çdo dëmtim apo shkatërrim i mobiljeve shkollore dhe materialit tjetër didaktik, apo i kompjuterave (testaturave, mausave, kabllave) do të jetë në llogari të nxënësve veçanërisht të prindërve të tyre. Varësisht nga dëmi i shkaktuar, pagesa mund të jetë edhe e dyfishuar.*
- 16. Nxënësve u ndalohet: Shfrytëzimi i telefonave celular gjatë orëve mësimore, pirja e duhanit apo alkoolit në shkollë, bartja e cigareve, alkoolit, drogës, thikave, thuprave, zinxhirëve, etj. me të cilat mundet të shkaktojnë lëndime trupore.*
- 17. Të mos ketë zënka apo rrahje mes veti individualisht apo në grupe.*
- 18. Hyrja dhe shëtitja e panevojshme nëpër zyrën e arsimtarëve është e ndaluar.*